

# BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



## Korrik 2023

**Përmbajtja:**

- **Workshopi:** "Cyber Defence Strategy Development"
- **Ballkani Perëndimor:** Bashkëpunimi Transatlantik dhe Rajonal- Ndërtimi i Aleancave të Forta
- **AKCESK Pjesmarrës Në Trajnimin Për Reagimin Ndaj Incidenteve Kibernetike Për Infrastrukturat Kritike Të Informacionit**



### Workshopi: "Cyber Defence Strategy Development"

Në datat 18-21 Korrik 2023, Instituti për Qeverisjen e Sigurisë i Agjencisë së Bashkëpunimit të Sigurisë së Mbrojtjes së SHBA-së, organizoi pranë ambjenteve të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, workshopin "Cyber Defence Strategy Development".

Pjesëmarrës në këtë workshop ishin përfaqësues nga Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Njësia Ushtarake e Sigurisë Kibernetike, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit dhe AKCESK.

Qëllimi i workshopit ishte zhvillimi dhe zbatimi i strategjisë së mbrojtjes kibernetike, për të mbështetur misionin dhe harmonizuar prioritetet, strukturat, vendimet dhe objektivat e Ministrisë së Mbrojtjes, për mbrojtjen e hapësirës kibernetike shqiptare.



### AKCESK Pjesmarrës Në Trajnimin Për Reagimin Ndaj Incidenteve Kibernetike Për Infrastrukturat Kritike Të Informacionit

Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve teknike të Infrastrukturave Kritike, Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike mori pjesë në trajnimin katër ditor të zhvilluar nga USEA dhe Catalisto së bashku me asistimin e USAID në Tiranë.

Fokusi i programit ishte thellimi i njohurive të avancuara në menaxhimin e incidenteve kibernetike në infrastrukturat publike dhe private në Shqipëri si dhe vlerësimin e implementimit të masave të sigurisë bazuar në standardet më të njohura ndërkombëtare.

Pjesëmarrja aktive në këtë trajnim i shërben AKCESK drejtpërdrejt në krijimin e kapaciteteve të qëndrueshme për të adresuar krizat e mundshme përmes forcimit të strategjive, inovacionit dhe sigurinë kibernetike.



### Ballkani Perëndimor: Bashkëpunimi Transatlantik dhe Rajonal- Ndërtimi i Aleancave të Forta

Në datën 13 korrik në Washington, D.C , u organizua Konferenca Ballkani Perëndimor: Bashkëpunimi Transatlantik dhe Rajonal - Ndërtimi i Aleancave të Forta.

Konferenca mbledhi përfaqësues të rëndësishëm, me qëllim bashkëpunimin rajonal , i cili është thelbësor për vendet e Ballkanit Perëndimor në progresin e procesit të stabilizimit asociativ në BE.

Gjatë sesionit "Cyber Security in the Western Balkans: Meeting the Challenges" Shqipëria, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm i AKCESK Z. Igli Tafa, prezantoi sfidat e sigurisë duke rikujtuar sulmin e një viti më parë drejtuar Shqipërisë , ne të cilin u përvetësuan dy terma kryesorë: terma teknologjik ku fokus ka qenë rritja e kapaciteteve teknologjike si dhe terma strategjik ku në fokus ka qenë ngritja e kapaciteteve njerëzore.

Gjithashtu, në vijim të diskutimeve të këtij sesioni, kreu i AKCESK theksoi suportin e partnerëve strategjik dhe rëndësinë e bashkëpunimeve të vazhdueshme për të përballuar në mënyrë të qëndrueshme situata kritike.

Konferenca vijoi diskutimet duke adresuar sfidat, sulmet e vazhdueshme kibernetike ndaj institucioneve dhe individëve publikë dhe privatë dhe cilat janë masat e duhura për tu ndërmarrë në terma strategjik dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë.



### Workshop: "Qeverisja e krizës kibernetike"

Në kuadër të zhvillimit të kapaciteteve të infrastrukturave të informacionit, AKCESK në bashkëpunim me CRDF Global dhe C3I organizuan workshopin mbi "Qeverisjen e krizës kibernetike".

Qëllimi i workshopit ishte fuqizimi i bashkëpunimit ndërsektorial në terma të qeverisjes së krizës kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet skenarëve të dedikuar fiktivë.

# BULETIN I LAJMEVE TË SIGURISË KIBERNETIKE



## Përmbajtja:

- Shqipëria mbështet miratimin e Progres Raportit Vjetor të OEWG në OKB
- Apple lançon një përditësim urgjent për të adresuar një defekt në iOS dhe macOS
- CISA u jep afat agjencive civile amerikane deri më 1 gusht për të zgjidhur katër dobësi të Microsoft
- Microsoft - Patching Alert




### Shqipëria mbështet miratimin e Progres Raportit Vjetor të OEWG në OKB

Sesioni i pestë i "Open-Ended Working Group (OWEG) On security of and in the use of information and communications technologies" zhvilloi punimet e tij në datat 24-28 korrik 2023 dhe konkludoi me miratimin e Progres Raportit Vjetor. Progres Raporti përfaqëson një udhëzim të punës së ardhshme të OEWG dhe reflekton mbi peizazhin dinamik të kërcënimeve në ekosistemin kibernetik.

Shqipëria, përfaqësuar me Misionin e Përhershëm pranë OKB dhe Drejtorin e AKCESK Znj. Edlira Gjollëshi, pas kontributit në hartimin e Programme of Action dhe rolin aktiv në sesionin e katërt të OEWG të zhvilluar në 6-10 Mars, mbështetën miratimin e Progres Raportit Vjetor, duke e konsideruar si një mjet të nevojshëm për punën e ardhshme të OEWG. Progres raporti propozon hapa konkretë për të avancuar paqen dhe sigurinë në hapësirën kibernetike, duke reflektuar zhvillimet e fundit në fushën e sigurisë kibernetike në kontekstin e sigurisë ndërkombëtare.

AKCESK, në cilësinë e autoritetit përgjegjës të fushës së sigurisë kibernetike në nivel kombëtar, vijon të ndjekë diskutimet ndërkombëtare të fushës, në koordinim të plotë me strukturat e ministries së linjës dhe misionin e Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë.



### Apple lançon një përditësim urgjent për të adresuar një defekt në iOS dhe macOS

Apple sapo ka publikuar për përdoruesit e saj një përditësim urgjent për të rregulluar hapësirat e zbuluara në sistemet e sigurisë të iOS dhe MAC. Dobësia u zbulua në motorin e shfletuesit WebKit të Apple dhe i lejon sulmuesit të marrin ekzekutimin arbitrar të kodit në pajisjet e synuara duke mashtruar përdoruesit për të hapur faqet e internetit me informacione të krijuara me qëllim keqdashës.

Përdoruesit e iOS dhe MAC të bëjnë sa më shpejt përditësimet e nevojshme dhe të mbajnë të aktivizuar në aparatet e tyre opsionin e përditësimeve automatike.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit e apple të kruejnë përditësimet e nevojshme

[Lexo më shumë](#)



### CISA u jep afat agjencive civile amerikane deri më 1 gusht për të zgjidhur katër dobësi të Microsoft

Agjencia e Sigurisë Kibernetike dhe Sigurisë së Infrastrukturës (CISA) u ka dhënë afat agjencive civile federale të SHBA-së deri më 1 gusht për të zgjidhur katër vulnerabilitete serioze zero-day të shpallura si pjesë e lëshimit mujor të Microsoft Patch Tuesday

Përfshirja e katër vulnerabiliteteve - CVE-2023-32046, CVE-2023-32049, CVE-2023-35311, CVE-2023-36874 - në katalogun e CISA do të thotë se dobësitë tashmë janë duke u shfrytëzuar nga hakerat. Katër dobësitë e përmendura të Microsoft janë ndër më shumë se 130 të shpallura nga gjigandi i teknologjisë të martën

Microsoft konfirmoi se vulnerabilitetet ishin duke u shfrytëzuar dhe preknin të gjitha versionet e Microsoft Outlook nga viti 2013 e tutje. Përveç njoftimeve të Microsoft, disa kompani të tjera, duke përfshirë Apple, Google, SAP, Fortinet, Adobe dhe Cisco, publikuan këshilla për dobësitë e tyre.

[Lexo më shumë](#)



### Microsoft - Patching Alert

Publikimi i ri i përditësimeve të sigurisë së Microsoft adreson 132 dobësi sigurie në produkte, nga të cilat 6 vulnerabiliteti të tipit zero-day.

AKCESK rekomandon të gjithë përdoruesit të instalojnë përditësimet e nevojshme.

[Lexo më shumë](#)